

Procesverbal- Tipi i kontratës - Mallra

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

Objekti i procedurës: “Blerje kosha dekorativë dhe plastikë”.

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (FPP): Kosha mbeturinash: 39224340-3

Vlera e fondit limit: 5 296 000 (pesë milionë e dyqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë) Lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Himarë, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 82 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar).

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 83 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) dhe nenin 30 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar).

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriterë duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 25 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar. Ky kriter synon të sigurojë që çdo operator ekonomik të konfirmojë paraprakisht, nën përgjegjësi ligjore, përmbushjen e kushteve dhe kërkesave të përgjithshme të parashikuara nga legjislacioni në fuqi për prokurimin publik.

Përmes vetëdeklarimit mundësohet një zhvillim më efikas i procedurës së vlerësimit të ofertave, duke shmangur ngarkesën administrative të paraqitjes së menjëhershme të dokumentacionit të plotë nga të gjithë ofertuesit, ndërkohë që autoriteti kontraktor ruan të drejtën për të kërkuar dhe

verifikuar dokumentacionin provues përkatës në fazat e mëvonshme të procedurës, në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024 dhe 2025 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 39 % e vlerës së fondit limit që prokurohet. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar; nenin 43 pika 2/c dhe nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: *“Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”*. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijimin e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomikë ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën siç është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se 39 % e vlerës së fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/c ku përcaktohet se: *“Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar...”*. Në nenin 55 pika 4 të VKM Nr 285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar është përcaktuar se: *“Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkohen në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave”*.

Referuar sa më sipër duke qënë se vlera e fondit limit është në kufirin e vlerës që i përket llojit të procedurës “Procedurë e hapur të thjeshtuar” edhe vlera e kërkuar për xhiron do të vendoset konform kësaj procedure prokurimi referuar dispozitave ligjore si më sipërcituar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 19 % e vlerës së fondit limit që prokurohet. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, ku parashikohet se “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën” nenit 55, pika 4(b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar ku përcaktohet se “Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 19 % të vlerës së fondit limit. Kjo vlerë është vendosur duke marrë parasysh përcaktimet e bëra në nenin 55 pika 4 gërma (b) e VKM nr. 285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, duke qënë se vlera e fondit limit është nën kufirin e ulët monetar që zhvillohet procedura e hapur e thjeshtuar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe provojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.2 Në rast se operatori ekonomik nuk është prodhues i artikujve objekt prokurimi, duhet të paraqesë autorizim prodhuesi/autorizim distributor/marrëveshje bashkëpunimi/kontratë furnizimi ose dokument tjetër ekuivalent, që provon të drejtën e operatorit ekonomik për të ofruar dhe furnizuar produktet objekt prokurimi.

Në rast të paraqitjes së autorizimit nga distributori, operatori ekonomik duhet të paraqesë edhe dokumentacionin që provon marrëdhënien dhe lidhjen ndërmjet distributorit dhe prodhuesit.

Në rast se operatori ekonomik është prodhues i produkteve objekt prokurimi, duhet të deklarojë këtë fakt dhe të paraqesë dokumentacionin përkatës që provon veprimtarinë prodhuese dhe aftësinë për prodhimin e artikujve objekt prokurimi ose të artikujve të ngjashëm.

Në çdo rast, autorizimi i prodhuesit/distributorit duhet të përmbajë elementë të qartë dhe autentikë identifikues të prodhuesit ose markës, si: logo, adresë zyrtare, website, adresë elektronike (e-mail), numër telefoni ose të dhëna të tjera identifikuese, me qëllim verifikimin e burimit të dokumentit dhe lidhjen e tij me produktin e ofruar.

Argumentimi: Ky kriter gjen mbështetje në nenin 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe pikën 5 të nenit 44 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku parashikohet se “5. Kur është e dukshme që një operator ekonomik e ka të pamundur të marrë etiketën specifike, të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor ose një etiketë ekuivalente, brenda afateve kohore përkatëse, për shkaqe që nuk lidhen me atë operator ekonomik, autoriteti ose enti kontraktor pranon mënyra të tjera

vërtetimi të përshtatshme, që mund të përfshijnë një dosje teknike nga prodhuesi, nëse operatori ekonomik në fjalë vërteton se punët, furnizimet ose shërbimet që ai duhet të ofrojë përmbushin kërkesat e etiketës specifike ose kërkesat specifike të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor”. Kërkesa që operatori ekonomik të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose nga distributori i autorizuar për artikujt e specifikuar, lidhet drejtpërdrejt me garantimin e cilësisë, origjinës dhe sigurisë së produkteve objekt prokurimi.

Objekti i kësaj procedure konsiston në furnizimin me kosha plastikë për mbetjet urbane me kapacitet 1100 litra dhe 240 litra, si dhe kosha metalikë dekorativë me kapacitet 110 litra, të cilët janë produkte që do të përdoren në ambiente publike dhe duhet të plotësojnë kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Për këtë arsye, Autoriteti Kontraktor ka detyrimin të sigurohet që operatori ekonomik disponon një burim të ligjshëm, të qëndrueshëm dhe të verifikueshëm furnizimi, në mënyrë që të garantohet realizimi korrekt i kontratës dhe furnizimi me produkte që përmbushin specifikimet teknike të kërkuara.

Kërkesa që operatori ekonomik, në rast se nuk është prodhues, të paraqesë autorizim prodhuesi/autorizim distributor/marrëveshje bashkëpunimi/kontratë furnizimi ose dokument tjetër ekuivalent, ka si qëllim të provojë të drejtën e tij për të tregtuar dhe furnizuar produktet objekt prokurimi dhe të garantojë ekzistencën e një marrëdhënieje reale tregtare me subjektin që i prodhon ose i shpërndan ato. Në rastet kur autorizimi lëshohet nga distributori, paraqitja e dokumentacionit që provon marrëdhënien ndërmjet distributorit dhe prodhuesit është e domosdoshme për të garantuar gjurmueshmërinë e zinxhirit të furnizimit dhe për të verifikuar se distributori vepron në mënyrë të autorizuar nga prodhuesi.

Në rast se operatori ekonomik është vetë prodhues i artikujve objekt prokurimi, paraqitja e dokumentacionit që provon ushtrimin e aktivitetit prodhues dhe aftësinë për prodhimin e artikujve objekt prokurimi ose të artikujve të ngjashëm është e nevojshme për të vërtetuar kapacitetin real teknik dhe prodhues për realizimin e kontratës.

Gjithashtu, kërkesa që autorizimi i prodhuesit ose distributorit të përmbajë elementë autentikë identifikues, si logo, adresë zyrtare, faqe interneti, adresë elektronike, numër telefoni ose të dhëna të tjera identifikuese, nuk përbën një kriter shtesë kualifikimi, por një mekanizëm verifikimi që i mundëson Autoritetit Kontraktor të kontrollojë autenticitetin e dokumentit dhe burimin e tij, duke parandaluar paraqitjen e dokumenteve të pavërteta ose të lëshuara nga subjekte që nuk kanë lidhje me prodhuesin e produkteve të ofertuara.

Kriteri nuk kufizon pjesëmarrjen vetëm tek operatorët që disponojnë autorizim prodhuesi, por lejon paraqitjen edhe të autorizimit të distributorit, marrëveshjes së bashkëpunimit, kontratës së furnizimit ose çdo dokumenti tjetër ekuivalent që provon të drejtën e operatorit ekonomik për të furnizuar produktet objekt prokurimi. Ky kriter është i nevojshëm për të garantuar realizimin me sukses të kontratës, sigurimin e origjinës së produkteve dhe mbrojtjen e interesit publik në përdorimin efektiv të fondeve publike.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog teknik/broshurë teknike ose dokumentacion teknik të lëshuar nga prodhuesi, për të gjitha mallrat objekt prokurimi.

Në katalogun/broshurën teknike duhet të evidentohen në mënyrë të qartë dhe të dallueshme produktet e ofruara nga operatori ekonomik, si dhe specifikimet teknike përkatëse të tyre, me qëllim verifikimin e përputhshmërisë së produkteve të ofertuar me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Katalogu ose broshura teknike duhet të përmbajë elementë të qartë dhe autentikë të prodhuesit/markës, si: logo, website, adresë elektronike (e-mail), numër telefoni, adresë zyrtare ose të dhëna të tjera identifikuese, të cilat mundësojnë verifikimin e burimit të dokumentacionit dhe lidhjen e tij me produktin e ofertuar.

Në rastet kur paraqiten pjesë të shkëputura nga katalogu ose broshura teknike, dokumentacioni duhet të tregojë qartë se pjesa e paraqitur është pjesë përbërëse e katalogut/broshurës përkatëse dhe duhet të identifikojë produktin, modelin, markën dhe prodhuesin të cilit i përket.

Mosparaqitja e katalogut/broshurës teknike, ose paraqitja e dokumentacionit teknik nga i cili nuk identifikohet qartë produkti i ofertuar, prodhuesi ose marka përkatëse, përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është bazuar në nenin 77 pika 1 dhe 4 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.” dhe në nenin 40 pika 6/b të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. ku përcaktohet se: “6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: b) fotografitë apo katalogët teknikë;”. Me anë të këtij kriteri, kërkohet që të verifikohet përputhshmëria e specifikimeve teknike, duke garantuar që produktet e ofruara i përmbushin të gjitha kërkesat teknike, funksionale dhe standartet e përcaktuara në specifikimet teknike në dokumentat e tenderit.

Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi, i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar mallrat e kërkuar, si dhe për të krahasuar pajtueshmërinë e specifikimeve teknike dhe standartet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor në dokumentet e tenderit, me specifikimet teknike të mallrave të ofruara nga operatori ekonomik.

Duke qenë se objekti i procedurës është furnizimi me kosha plastikë për mbetjet urbane me kapacitet 1100 litra dhe 240 litra, si dhe kosha metalikë dekorativë me kapacitet 110 litra, është e domosdoshme që Autoriteti Kontraktor të disponojë dokumentacion teknik zyrtar mbi bazën e të cilit të vlerësojë karakteristikat teknike të produkteve të ofertuara dhe përputhshmërinë e tyre me kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike.

Kërkesa për paraqitjen e katalogut Teknik/broshurës teknike ose dokumentacionit teknik të lëshuar nga prodhuesi nuk synon të kufizojë konkurrencën, por të sigurojë që vlerësimi i ofertave të mbështetet mbi dokumentacion zyrtar dhe objektiv, i cili pasqyron karakteristikat reale të produkteve. Vetëm nëpërmjet dokumentacionit teknik të prodhuesit Autoriteti Kontraktor mund të verifikojë kapacitetin, dimensionet, materialin e prodhimit, karakteristikat konstruktive, standardet teknike, si dhe çdo element tjetër të kërkuar në dokumentet e tenderit, duke shmangur deklaratimet e njëanshme të operatorëve ekonomikë që nuk mbështeten në dokumentacion zyrtar.

Kërkesa që në katalog ose broshurë të evidentohen qartë produktet e ofruara dhe specifikimet teknike përkatëse është vendosur për të mundësuar identifikimin e saktë të modelit që ofrohet në këtë procedurë dhe për të shmangur paraqitjen e katalogëve të përgjithshëm që përmbajnë një numër të madh produktesh pa identifikuar konkretisht artikullin objekt ofertimi. Në mungesë të këtij identifikimi, Autoriteti Kontraktor nuk do të ishte në gjendje të verifikonte në mënyrë objektive nëse produkti i ofertuar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara.

Po kështu, kërkesa që katalogu ose broshura teknike të përmbajë elementë autentikë identifikues të prodhuesit ose markës, si logo, adresë zyrtare, faqe interneti, adresë elektronike, numër telefoni ose të dhëna të tjera identifikuese, nuk përbën një kriter shtesë kualifikimi, por një mekanizëm verifikimi të autenticitetit të dokumentacionit teknik. Këto të dhëna i mundësojnë Autoritetit Kontraktor të verifikojë burimin e dokumentit, të konfirmojë se ai është lëshuar nga prodhuesi ose nga burime zyrtare të tij dhe të shmangë përdorimin e dokumentacionit joautentik ose të modifikuar.

Edhe kërkesa që, në rastet kur paraqiten vetëm pjesë të shkëputura të katalogut ose broshurës teknike, ato të identifikojnë qartë produktin, modelin, markën dhe prodhuesin, është një kërkesë proporcionale dhe e nevojshme, pasi synon të sigurojë që fragmentet e paraqitura janë pjesë e dokumentacionit teknik zyrtar dhe i referohen pikërisht produktit të ofertuar. Kjo shmang situatat kur paraqiten faqe të veçuara, të cilat nuk mund të lidhen me një katalog të caktuar ose nuk identifikojnë qartë produktin që propozohet për furnizim.

Parashikimi se mosparaqitja e katalogut ose broshurës teknike, ose paraqitja e dokumentacionit nga i cili nuk identifikohet qartë produkti, modeli, marka ose prodhuesi, përbën shkak për skualifikim, lidhet me pamundësinë objektive të Autoritetit Kontraktor për të verifikuar përputhshmërinë e ofertës me specifikimet teknike. Në mungesë të këtij dokumentacioni nuk është e mundur të konstatohet nëse produkti i ofertuar përmbush kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit, çka cenon parimin e trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë dhe zhvillimin e një vlerësimi objektiv e transparent të ofertave.

Kriteri i kualifikimit është vendosur në funksion të verifikimit të përputhshmërisë teknike të mallrave të ofertuara, duke respektuar parimet e transparencës, proporcionalitetit, trajtimit të barabartë dhe përdorimit me efektivitet të fondeve publike, të parashikuara në Ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të vërtetojë përputhshmërinë e produkteve të ofruara me standardet, normat dhe referencat teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor në specifikimet teknike për mallrat objekt prokurimi.

Në përmbushje të kësaj kërkesë, operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikata konformiteti, deklarata konformiteti/deklarata performance/raporte testimi ose dokumentacion tjetër

ekuivalent, të lëshuara nga prodhuesi ose nga institucione/organe të pavarura të vlerësimit të konformitetit, të akredituara sipas legjislacionit në fuqi, sipas rastit.

Dokumentacioni i paraqitur duhet të provojë se produktet e ofruara përmbushin standardet, normat teknike dhe kërkesat e përcaktuara në shtojcën e specifikimeve teknike të dokumenteve të tenderit.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 79 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe në pikën 1 të nenit 44, të VKM-së Nr. 285 datë 09.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Në nenin 79 pika 1 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, përcaktohet se: *“1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.”*

Në nenin 44 pika 1 të VKM-së Nr. 285 datë 09.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, përcaktohet se: *“1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.”*

Ky kriter kualifikimi përbën një element thelbësor teknik për garantimin e sigurisë, cilësisë dhe qëndrueshmërisë së mallrave që do të furnizohen në kuadër të këtij prokurimi. Duke qenë se objekti i kësaj procedure përfshin furnizimin me kosha për mbetjet urbane është e nevojshme që përputhshmëria e këtyre produkteve me standardet teknike të mos mbështetet vetëm në deklaratimet e operatorit ekonomik, por të provohet nëpërmjet dokumentacionit teknik të lëshuar nga prodhuesi ose nga organe të pavarura të vlerësimit të konformitetit.

Kërkesa për paraqitjen e certifikatave të konformitetit, deklaratave të konformitetit, deklaratave të performancës, raporteve të testimit ose dokumentacionit tjetër ekuivalent synon të garantojë që produktet e ofertuara janë prodhuar dhe testuar në përputhje me standardet dhe normat teknike të kërkuara në specifikimet teknike. Ky dokumentacion përbën mjetin më të përshtatshëm dhe objektiv për të provuar karakteristikat teknike, cilësinë, performancën dhe përputhshmërinë e produkteve me kërkesat e Autoritetit Kontraktor, duke garantuar që mallrat e furnizuara do të jenë të përshtatshme për përdorimin e tyre në ambiente publike.

Parashikimi që dokumentacioni të jetë i lëshuar nga prodhuesi ose nga institucione apo organe të pavarura të vlerësimit të konformitetit, të akredituara sipas legjislacionit në fuqi, është në përputhje me legjislacionin në fushën e standardizimit dhe vlerësimit të konformitetit dhe synon të sigurojë besueshmërinë, objektivitetin dhe vlefshmërinë e dokumenteve të paraqitura. Një dokument i lëshuar nga një organ i akredituar ose nga vetë prodhuesi, sipas natyrës së dokumentit, përbën garanci se produkti është testuar ose deklaruar në përputhje me kërkesat teknike përkatëse dhe se informacioni i paraqitur është i verifikueshëm.

Kërkesa është hartuar në mënyrë proporcionale, pasi nuk kufizon operatorët ekonomikë në paraqitjen e një lloji të vetëm dokumentacioni, por pranon çdo dokument ekuivalent që provon përputhshmërinë e produktit me standardet dhe kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Në këtë mënyrë garantohej respektimi i parimit të mosdiskriminimit dhe trajtimit të barabartë, duke u dhënë mundësi të gjithë operatorëve ekonomikë të provojnë përputhshmërinë e produkteve të tyre me forma të ndryshme dokumentacioni teknik, sipas praktikave të prodhuesit dhe legjislacionit të vendit të origjinës.

Kërkimi i këtij dokumentacioni është i domosdoshëm edhe për të mundësuar një vlerësim objektiv të ofertave dhe për të shmangur furnizimin me produkte që nuk plotësojnë standardet e kërkuara ose që nuk ofrojnë nivelin e cilësisë, sigurisë dhe performancës të nevojshme për përdorimin e tyre në shërbimet publike. Në mungesë të dokumentacionit që provon përputhshmërinë me standardet dhe normat teknike, Autoriteti Kontraktor nuk do të kishte mundësi të verifikonte në mënyrë të besueshme nëse produktet e ofertuara përmbushin kërkesat minimale të përcaktuara në specifikimet teknike.

Për rrjedhojë, kriteri i kualifikimit është i lidhur ngushtë me objektin e kontratës, është proporcional me natyrën e mallrave që prokurohen dhe është vendosur për të garantuar furnizimin me produkte që përmbushin standardet e kërkuara të cilësisë dhe performancës.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentin e titulluar "Ofertë Teknike", të hartuar sipas modelit të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor dhe të paraqitur në formën e një tablele.

Dokumenti "Ofertë Teknike" duhet të plotësohet në mënyrë të plotë dhe të saktë për të gjithë zërat objekt prokurimi dhe duhet të përmbajë minimalisht të dhënat e mëposhtme:

<i>Nr</i>	<i>Emertimi i produkteve</i>	<i>Emertimi kompanise prodhuese, adresa , website, dhe link-u i katalogut/produktit ne website.</i>	<i>Emertimi i katalogut</i>	<i>Kodi i produktit dhe nr. faqes ne katalog.</i>
-----------	------------------------------	---	-----------------------------	---

Emërtimi i produkteve duhet të bëhet sipas listës së produkteve dhe specifikimeve teknike të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor në dokumentet e tenderit.

Operatori ekonomik duhet të deklarojë emrin e kompanisë prodhuese, adresën, website-in zyrtar, katalogun/broshurën/skedën teknike të prodhuesit, si dhe referencën përkatëse në katalog, kodin e produktit ose numrin e faqes ku evidentohen specifikimet teknike të produktit të ofertuar.

Në rast se produkti nuk disponon kod specifik identifikimi në katalogun e prodhuesit, operatori ekonomik duhet të paraqesë referencën përkatëse ose numrin e faqes në dokumentacionin teknik ku Autoriteti Kontraktor mund të verifikojë specifikimet e plota teknike të produktit të ofertuar.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar ku përcaktohet se: “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti

kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.” dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, ku përcaktohet se: “8. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”. Në këtë kontekst është kërkuar dhe oferta teknike në formë deklarative, me anë të së cilës do të bëhet i mundur verifikimi më i saktë i artikujve të ofertuar, origjina, konformiteti me dokumentacionin mbështetës të paraqitur nga ofertuesi. Duke marrë shkas nga kompleksiteti i artikujve objekt prokurimi, gjykohet e nevojshme që gjatë fazës së vlerësimit komisioni i vlerësimit të ofertave të njihet me ofertën teknike, për të bërë të mundur një vlerësim sa më eficient dhe sa më të mirëorientuar.

Ky kriter kualifikimi përbën një element thelbësor për garantimin e një procesi vlerësimi të saktë, të krahasueshëm dhe transparent të ofertave të paraqitura nga operatorët ekonomikë. Kriteri i kualifikimit lidhet drejtpërdrejt me nevojën e Autoritetit Kontraktor për të kryer një vlerësim të saktë, objektiv dhe të verifikueshëm të përputhshmërisë së produkteve të ofertuara me specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Duke qenë se objekti i procedurës përfshin furnizimin me kosha plastikë për mbetjet urbane është e nevojshme që të gjitha informacionet teknike mbi produktet e ofertuara të paraqiten në një format të unifikuar dhe të standardizuar, i cili mundëson krahasimin dhe verifikimin e ofertave në mënyrë të barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë.

Kërkesa për paraqitjen e dokumentit “Ofertë Teknike”, sipas modelit të hartuar nga Autoriteti Kontraktor, nuk përbën një kriter shtesë kualifikimi, por një mënyrë të organizimit dhe paraqitjes së informacionit teknik, me qëllim lehtësimin e procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave. Ky dokument shërben si një tabelë referuese, nëpërmjet së cilës Autoriteti Kontraktor identifikon për secilin produkt prodhuesin, modelin, katalogun teknik, kodin e produktit dhe referencën përkatëse në dokumentacionin teknik, duke bërë të mundur verifikimin e menjëhershëm të përputhshmërisë me specifikimet teknike të kërkuara.

Kërkesa që operatori ekonomik të deklarojë emrin e kompanisë prodhuese, adresën, faqen zyrtare të internetit, emërtimin e katalogut ose broshurës teknike, kodin e produktit dhe numrin e faqes ku gjenden karakteristikat teknike, është e domosdoshme për të garantuar gjurmueshmërinë dhe identifikimin e saktë të produktit të ofertuar. Këto të dhëna i mundësojnë Autoritetit Kontraktor të kryejë një verifikim të shpejtë dhe objektiv të dokumentacionit teknik të paraqitur, duke shmangur pasaktësitë, paqartësitë ose interpretimet subjektive gjatë fazës së vlerësimit të ofertave.

Po kështu, parashikimi që, në rastet kur produkti nuk disponon kod specifik identifikimi në katalogun e prodhuesit, operatori ekonomik të paraqesë referencën ose numrin e faqes ku evidentohen specifikimet teknike, është një kërkesë proporcionale dhe e arsyeshme, e cila nuk kufizon konkurrencën, por siguron që çdo produkt i ofertuar të jetë i identifikueshëm dhe i verifikueshëm në dokumentacionin teknik zyrtar të prodhuesit. Kjo shmang situatat në të cilat Autoriteti Kontraktor nuk është në gjendje të përcaktojë se cilit produkt i referohet dokumentacioni i paraqitur ose nëse karakteristikat teknike të tij përputhen me kërkesat e tenderit.

Dokumenti “Ofertë Teknike” nuk kërkon paraqitjen e informacionit që operatori ekonomik nuk e disponon, por vetëm sistemimin në një format të unifikuar të të dhënave që burojnë nga katalogët, broshurat dhe dokumentacioni teknik i prodhuesit, të cilat kërkohen edhe nga kriteret e tjera të dokumenteve të tenderit. Për këtë arsye, plotësimi i tij nuk krijon barrë të panevojshme për

operatorët ekonomikë dhe nuk cenon parimin e proporcionalitetit, por kontribuon në zhvillimin e një procesi vlerësimi më transparent, më efikas dhe të bazuar në dokumentacion të verifikueshëm. Kriteri i kualifikimit është i lidhur ngushtë me objektin e kontratës dhe është vendosur në funksion të garantimit të një procesi vlerësimi objektiv, transparent dhe të barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë, duke mundësuar verifikimin e saktë të produkteve të ofertuara dhe përputhshmërisë së tyre me specifikimet teknike të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor.

2.3.6 Operatori ekonomik, në datën dhe orën e përcaktuar për hapjen e ofertave, duhet të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor 1 (një) mostër për artikullin: "Kosh metalik për mbetje urbane me kapacitet 110 litra".

Mostra e paraqitur duhet të jetë në përputhje me produktin e deklaruar në ofertën teknike, katalogët/broshurat/skeda teknike të paraqitura nga operatori ekonomik, si dhe me specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Mostrat do të dorëzohen pranë Autoritetit Kontraktor në ditën dhe orën e hapjes së ofertave dhe do të administrohen nëpërmjet procesverbalit përkatës, në përputhje me Udhëzimin e Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 03, datë 12.04.2022 "Për administrimin e mostrave të paraqitura nga operatorët ekonomikë".

Mosparaqitja e mostrës, paraqitja e mostrës që nuk përputhet me produktin e deklaruar në dokumentacionin teknik, ose mospërputhja e saj me specifikimet teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor, përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me nenit 77 pika 1 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar ku përcaktohet se: "1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës." dhe pikën 6/a, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar, ku përcaktohet se: "6. Autoriteti/enti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve, pas nënshkrimit të kontratës ose marrëveshjes kuadër, me kusht që kontrata në fjalë ose marrëveshja kuadër të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit;".

Ky kriter kualifikimi ka për qëllim të sigurojë që operatori ekonomik të ofrojë produkte të verifikueshme dhe të krahasueshme në terren, duke mundësuar një vlerësim të saktë të përputhshmërisë së tyre me specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor. Kërkesa për

dorëzimin e mostrave fizike në ditën dhe orën e hapjes së ofertave është një procedurë standarde që synon të eliminojë çdo pasiguri në lidhje me cilësinë, dimensionet dhe funksionalitetin e pajisjeve që do të furnizohen, duke lehtësuar një kontroll të drejtpërdrejtë dhe objektiv.

Kërkesa për paraqitjen e mostrës lidhet drejtpërdrejt me objektin e kontratës dhe është vendosur me qëllim që Autoriteti Kontraktor të ketë mundësinë të verifikojë fizikisht përputhshmërinë e produktit të ofertuar me specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Kërkesa për mostër është kufizuar vetëm për artikullin “Kosh metalik për mbetje urbane me kapacitet 110 litra”, pasi ky produkt, për shkak të natyrës së tij dekorative dhe karakteristikave konstruktive, përmban elemente cilësore dhe estetike që nuk mund të vlerësohen në mënyrë të plotë vetëm nëpërmjet katalogëve, broshurave ose dokumentacionit teknik. Vlerësimi fizik i mostrës i mundëson Autoritetit Kontraktor të verifikojë cilësinë e materialit, trashësinë e llamarinës, cilësinë e saldimeve, përfundimin sipërfaqësor, trajtimin antikorroziv, cilësinë e lysterjes, elementët funksionalë, stabilitetin konstruktiv, përmasat dhe përputhshmërinë e përgjithshme të produktit me kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Kërkesa që mostra të jetë në përputhje me produktin e deklaruar në ofertën teknike, katalogët, broshurat ose dokumentacionin teknik të paraqitur nga operatori ekonomik, synon të garantojë se produkti që do të furnizohet gjatë ekzekutimit të kontratës është i njëjtë me produktin që është ofertuar dhe mbi bazën e të cilit është kryer vlerësimi teknik. Në këtë mënyrë shmanget mundësia që operatori ekonomik të paraqesë dokumentacion teknik për një produkt dhe të furnizojë një produkt tjetër me karakteristika të ndryshme nga ato të deklaruara në ofertë.

Administrimi i mostrës në datën dhe orën e hapjes së ofertave, nëpërmjet procesverbalit përkatës dhe në përputhje me Udhëzimin nr. 03, datë 12.04.2022 të Agjencisë së Prokurimit Publik, garanton transparencën, integritetin dhe trajtimin e barabartë të operatorëve ekonomikë gjatë gjithë procesit të vlerësimit. Procedura e administrimit të mostrave siguron ruajtjen, identifikimin dhe vlerësimin e tyre në kushte të njëjta për të gjithë pjesëmarrësit, duke eliminuar çdo mundësi trajtimi të pabarabartë ose ndërhyrjeje në proces.

Parashikimi se mosparaqitja e mostrës, paraqitja e një mostre që nuk përputhet me produktin e deklaruar në dokumentacionin teknik ose mospërputhja e saj me specifikimet teknike të kërkuara përbën shkak për skualifikim, është pasojë e pamundësisë objektive të Autoritetit Kontraktor për të verifikuar përputhshmërinë reale të produktit me kërkesat e tenderit. Në mungesë të mostrës ose në rast të mospërputhjes së saj me dokumentacionin teknik, Autoriteti Kontraktor nuk mund të garantojë se produkti që do të furnizohet do të përmbushë kërkesat teknike dhe cilësore të kontratës.

Kjo kërkesë është hartuar duke respektuar parimin e proporcionalitetit, pasi nuk kërkohet paraqitja e mostrave për të gjithë artikujt objekt prokurimi, por vetëm për produktin metalik dekorativ, për të cilin vlerësimi fizik është i domosdoshëm për shkak të karakteristikave të tij funksionale dhe estetike.

Argumentimi i specifikimeve teknike:

Specifikimet teknike përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që e vlerëson mallin si të pranueshëm për funksionet e kërkuara si dhe është në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

Specifikimet teknike janë hartuar në përputhje me nenet 36 dhe 37 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe me dispozitat e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duke respektuar parimet e proporcionalitetit, mosdiskriminimit dhe konkurrencës së lirë. Këto specifikime janë përcaktuar mbi bazën e nevojave funksionale të Autoritetit Kontraktor dhe të kushteve reale në të cilat do të përdoren produktet, me qëllim sigurimin e një furnizimi me mallra cilësore, të qëndrueshme dhe me jetëgjatësi të lartë.

Për koshat plastikë me kapacitet 1100 litra dhe 240 litra janë përcaktuar kërkesa që lidhen me kapacitetin, përmasat, materialin e prodhimit, rezistencën mekanike, rezistencën ndaj temperaturave dhe rrezatimit UV, sistemin e lëvizjes, kapacitetin mbajtës dhe standardet e prodhimit, pasi këto karakteristika ndikojnë drejtpërdrejt në funksionalitetin, sigurinë dhe jetëgjatësinë e produkteve gjatë përdorimit të përditshëm në shërbimin publik të grumbullimit të mbetjeve. Materiali HDPE (High Density Polyethylene) është kërkuar për shkak të rezistencës së tij të lartë ndaj goditjeve, korrozionit, kimikateve dhe kushteve atmosferike, si dhe për faktin se është materiali më i përdorur ndërkombëtarisht për prodhimin e kontejnerëve të mbetjeve urbane. Kërkesa që materiali të jetë rezistent ndaj rrezatimit UV dhe temperaturave nga -30°C deri në +80°C synon të garantojë ruajtjen e vetive mekanike të produktit gjatë gjithë periudhës së përdorimit, pavarësisht kushteve klimatike.

Përmasat e kërkuara për kontejnerët janë përcaktuar me toleranca të arsyeshme, të cilat mundësojnë pjesëmarrjen e prodhuesve të ndryshëm në treg dhe njëkohësisht sigurojnë përputhshmërinë e kontejnerëve me sistemet ekzistuese të grumbullimit dhe transportit të mbetjeve, si dhe me mekanizmat standardë të ngritjes dhe zbrazjes që përdoren nga automjetet teknologjike të Autoritetit Kontraktor. Edhe kërkesat për peshën minimale të kontejnerit dhe kapacitetin mbajtës janë vendosur për të garantuar që produkti të ketë rezistencë të mjaftueshme strukturore gjatë përdorimit intensiv dhe të mos deformohet gjatë ngritjes, transportit apo zbrazjes. Kërkesa për sistem kullimi në pjesën e poshtme të kontejnerit është vendosur për të lehtësuar largimin e lëngjeve të krijuara nga mbetjet dhe procesi i larjes, duke përmirësuar kushtet higjieno-sanitare dhe duke reduktuar aromat e pakëndshme. Kërkesat për kapakun, dorezat e integruara, rrotat me diametër minimal 200 mm, kushinetat dhe sistemin e frenimit janë përcaktuar për të garantuar manipulim të sigurt, transport të lehtë dhe qëndrueshmëri gjatë përdorimit në mjedisë urbane me ngarkesë të lartë.

Kërkesa që kontejnerët plastikë të jenë në përputhje me standardin EN 840 ose standard ekuivalent është vendosur pasi ky standard përbën referencën teknike evropiane për kontejnerët e lëvizshëm të mbetjeve dhe përcakton kërkesat për dimensionet, sigurinë, rezistencën mekanike, funksionalitetin dhe pajtueshmërinë me automjetet e grumbullimit të mbetjeve. Pranimi i standardeve ekuivalente garanton respektimin e parimit të mosdiskriminimit dhe konkurrencës së lirë.

Kërkesa për përputhshmëri me Direktivën 2000/14/EC dhe paraqitjen e markimit CE është vendosur për të garantuar që produktet përmbushin kërkesat evropiane në lidhje me pajtueshmërinë dhe performancën, ndërsa kërkesa për certifikimin e prodhuesit sipas standardeve ISO 9001, ISO 14001 dhe ISO 45001 ose ekuivalente synon të garantojë që produktet prodhohen në një sistem të certifikuar të menaxhimit të cilësisë, mjedisit dhe sigurisë në punë, duke rritur besueshmërinë dhe cilësinë e furnizimit.

Për koshin metalik dekorativ me kapacitet 110 litra janë përcaktuar kërkesa që lidhen me materialin, trashësinë e llamarinës, konstruksionin, procesin e galvanizimit, cilësinë e saldimeve, trajtimin sipërfaqësor dhe mekanizmat e funksionimit, pasi ky produkt do të vendoset në ambiente publike dhe duhet të përballojë përdorim intensiv, ekspozim të vazhdueshëm ndaj kushteve atmosferike dhe akteve të mundshme vandaliste. Përdorimi i llamarinës së galvanizuar me trashësi minimale 2 mm për trupin dhe 2.5 mm për kapakun garanton rezistencë të lartë mekanike dhe mbrojtje afatgjatë ndaj korrozionit.

Kërkesat për formën cilindrike, kapakun metalik njëpjesësh, menteshën, amortizatorin, mekanizmin e kyçjes me çelës trekëndor dhe sistemin Push & Turn janë vendosur për të garantuar përdorim të sigurt, mbrojtje nga ndërhyrjet e paautorizuara, lehtësi në zbrazjen e koshit dhe mbrojtje nga hyrja e ujërave të shiut apo depozitimi i mbetjeve voluminoze. Po kështu, kërkesa për kosh të brendshëm të lëvizshëm prej çeliku të galvanizuar me doreza transporti synon të lehtësojë procesin e zbrazjes dhe pastrimit, duke përmirësuar kushtet higjienike dhe mirëmbajtjen e produktit.

Kërkesa që sipërfaqja e jashtme të lyhet me bojë pluhur elektrostатike sipas specifikimeve Qualisteelcoat ose ekuivalente është vendosur për të garantuar rezistencë të lartë ndaj korrozionit, rrezatimit UV, konsumimit mekanik dhe agjentëve atmosferikë, duke siguruar ruajtjen e cilësisë estetike dhe funksionale të produktit gjatë gjithë jetës së tij të shërbimit. Përcaktimi i ngjyrës sipas sistemit RAL i mundëson Autoritetit Kontraktor të unifikojë elementët e mobilimit urban sipas nevojave të tij pa kufizuar konkurrencën.

Kërkesa që prodhuesi i koshit metalik të jetë i certifikuar sipas standardeve ISO 9001, ISO 14001, ISO 45001, ISO 3834-2 dhe ISO 9606 ose ekuivalente është vendosur për shkak të natyrës së procesit të prodhimit, i cili përfshin punime metalike dhe saldime strukturore. Standardet ISO 3834-2 dhe ISO 9606 garantojnë kontrollin e cilësisë së proceseve të saldimit dhe kualifikimin e salduesve, duke siguruar rezistencën strukturore dhe jetëgjatësinë e produktit.

Të gjitha standardet e kërkuara në dokumentet e tenderit janë shoqëruar me shprehjen “ose ekuivalent”, në përputhje me nenin 36 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, me qëllim garantimin e konkurrencës dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë. Gjithashtu, është parashikuar shprehimisht se do të pranohen edhe standarde kombëtare të adoptuara nga standardet evropiane ose ndërkombëtare, përfshirë standardet SSH/EN dhe SSH/ISO, të lëshuara nga organizma të akredituar të vlerësimit të konformitetit, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Për rrjedhojë, specifikimet teknike janë objektive, funksionale, proporcionale me objektin e prokurimit dhe nuk favorizojnë asnjë prodhues, markë apo operator ekonomik të caktuar, por synojnë të garantojnë furnizimin me produkte cilësore, të sigurta dhe me jetëgjatësi të përshtatshme për përdorim në shërbimin publik.

NJËSIA E PROKURIMIT